

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
“HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT**



PUNIMI I DIPLOMËS - MASTER

**NDIKIMI I FORCËS EKSPLOZIVE DHE STATIKE NË REALIZIMIN E
DISA DETYRAVE MOTORIKE SPECIFIKE NË VOLEJBOLL**

**MENTORI:
Dr. Sc. Musa Selimi**

**KANDIDATËT:
Florentina Deliu
Arbnor Jashari**

Prishtinë, 2019

PËRMBAJTJA

1. HYRJE	3
1.2 HULUMTIMET E DERITANISHME	8
2. QËLLIMI DHE DETYRAT	12
3. HIPOTEZAT THEMELORE	13
4. MOSTRA E ENTITETIT / TË TESTUARAVE/.....	14
4.1. MOSTRA E NDYSHOREVE	14
4.3. PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE	16
4.3.1 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike të forcës eksplozive.....	16
4.3.2 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike të forcës statike.....	22
4.3.3 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike specifike të precizitetit	28
4.4. METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE	33
5. INTERPRETIMI I REZULTATTEVE DHE DISKUSUTIMI	34
5.1. INTERPRETIMI I REZULTATTEVE TE VOLEJBOLLISTET	34
5.2. KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE.....	54
5.2.1 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS EKSPLOZIVE TE VOLEJBOLLISTET	54
5.2.2 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS STATIKE TE VOLEJBOLLISTET	55
5.2.3 KOEFICIENTËT E NDËRLIDHJEVE NDËRMJET NDRYSHOREVE MOTORIKE SPECIFIKE TË PRECIZITETIT TE VOLEJBOLLISTET	56
5.3. NDIKIMI I FORCËS EKSPLOZIVE, DHE FORCËS STATIKE NË DETYRAT MOTORIKE SITUACIONALE	57
5.4. VËRTETIMI I HIPOTEZAVE.....	67
6. PËRFUNDIMI	68
7. LITERATURA	70

1. HYRJE

Volejboli pa dyshim është njëri nga sportet e popullarizuara e së ardhmes, jep informacione për aftësitë dhe për faktorët e ndryshëm që mundësojnë ose pengojnë të arritura të njohurive shkencore në praktikën sportive. Konstelacioni i volejbollistit kërkon njohjen e disa karakteristikave antropomotorike, si lartësia trupore e cila është një faktorë i rëndësishëm, gjithashtu dhe aftësitë psikomotorike ku domosdo kërkohen për të arritur suksesin e dëshiruar dhe prezantuar të arriturat e gjithëmbarshme në volejboll. Shumë trajner, ekspert, profesor janë angazhuar dhe përqendruar në stërvitjet e teknikës, taktikës, përgatitjes fizike dhe asaj psikike pa të cilat nuk do të mund të formohet lojtari dhe ekipi. Për tu bërë një lojtar i mirë i volejbollit apo për të pasur një ekip të mirë, nevojiten përsëritje të elementeve teknike dhe taktike të lojës të cilat duhet ekzekutuar me mijëra herë për ti perfeksionuar ato. Për të ekzekutuar një numër të madh të përsëritjeve kërkohet përgatitja psiko-motorike e cila është bazë dhe siguri për punën e mëtutjeshme

Në bazë të modelit të karakteristikave antropologjike, volejbollistët kulmor, përveç karakteristikave antropometrike përfshijnë edhe aftësitë motorike si kërcim nga vendi dhe nga lëvizja si dhe zhvendosja në hapësirë në një distancë të afërt. Duke pasur parasysh se lartësia trupore e volejbollistëve me stërvitje nuk mund të ndryshohet, lartësia brenda mundësive në kërcim së larti për gjuajtje dhe bllokim (kërcim vertikal) mund të rritet me stërvitje sportive.

Forca eksplozive klasifikohet në saxe të mënyrës së ekzekutimit të tyre, intensitetit si dhe ekzekutimit në raport me pjesët ose fazave të përgatitjeve. Këtu është e rëndësishme të dihet ekzekutimi i drejt i çdo kërcimi, gradualitetit, dmth. metodologjia që duhet të aplikohet për të bërë përparim në kërcim, etj. E njëjta gjë vlen edhe për hedhjet të cilat mund të kryhen me topa medicinal ose gjyle si dhe mënyra të tjera për ushtrimet e forcës eksplozive e pjesës së sipërme të trupit.

Ushtrimet forcës eksplozive në stërvitje gjithashtu mund të kombinohet me ushtrime me pesha apo llojet e tjera të rezistencës. Këtu përsëri ka disa parime që duhet ti përmbahemi nëse dëshirojmë të zbatojmë stërvitje të llojit të këtill. Janë të rëndësishme për ne edhe shembujt të metodave forcës eksplozive nga autorë të ndryshëm që të shohim mënyrën në bazë të së cilës është organizuar stërvitja e till dhe që në bazë të së cilës mundemi vetëm të bëjmë programin stërvitor.

Një segment të rëndësishëm e përbëjnë edhe testet me ndihmën e të cilave vërtetojmë ose e përcaktojmë statusin aktual (fillestar) të një sportisti, gatishmërinë e tij për të kryer ushtrime të forcës eksplozive dhe krahasimin me sportistët të tjerë dhe karakteristikat e modeleve për sporte të caktuara ose nivele apo mosha në të cilën është sportisti. Nëse forcën eksplozive e zbatojmë në një sport të caktuar, është logjike që ne duhet të analizojmë mirë sportin e caktuar dhe të vlerësojmë të gjitha karakteristikat e tij që të mund të bëjë një plan të mirë dhe program të forcës eksplozive i cili do të jap një rezultat të mirë. Nuk duhet të na ndodhë që me zbatimin e një metode të caktuar të rritjes së forcës eksplozive të marrim efektin e kundërt nga ai që e dëshirojmë.

Pas kësaj, vijmë në një kulm, i cili i referohet programit të stërvitjes i cili zbatohet në lojën e volejbollit, dhe i cili duhet të kontribuojë për një rezultat më të mira dhe përparimin në lojën e vplejbollit. Në akcionet e gjuajtjes dhe bllokut dominon forca e duhur eksplozive, e cila identifikohet si kërcim në volejboll dhe nga kjo shpesh varet fitimi i pikëve. Problemin e precizitetit e kanë hulumtuar shumë autorë. Njohurit e tyre kanë përfshirë kryesisht fushat e strukture së lojës të volejbollistët dhe kryerjen e detyrave motorike në trajningun situacional ose lojën e volejbollit (Бернштейн, 1990; Gajić, 2005; Janković, 1988; Karalić, 2007; Ляхова и Стрельникова, 2007; Немцев, 2003; Nešić, 2006; Stojanović i Milenkoski, 2005).

Forca statike është aftësia e volejbollistëve për të mbajtur kontrahimin maksimal izometrik të muskujve, kur tendosja e tyre ka një pozicion ose qëndrim të caktuar. Për zhvillimin e forcës, aplikohet stërvitja izometrike, është e rëndësishme që muskujt të kontraktohen nën një kënd të caktuar të nyjeve në të cilin arrihet lëvizja e dëshiruar, dmth. në të njëjtën kënd si në aktivitetet garuese (parimi i specificitetit). Mënyra më efektive për zhvillimin e forcës statike është metoda e ngacmoimit izometrik me ngarkesa, të cilat janë nga të larta deri në maksimum. Studimet kanë treguar se një tkurrje maksimale (që zgjat vetëm një sekondë), përsëritur 5-10 herë në ditë, çon në një rritje të konsiderueshme në forcën e grupeve të muskujve të dhënë. Një rezultat i ngjashëm mund të fitohen nëse prodhohet 2/3 e tkurrjes maksimale për 5 deri në 6 sekonda.

Në këto sportet ekipore përgatitja fizike në fazën përgatitore është vendimtare për arrijtjen e rezultateve të larta sportive. Prandaj, vëmendje e veçantë i kushtohet përzgjedhjes së procedurave metodike dhe ushtrimeve të cilat, në përputhje me mundësitë e teknikës së realizimit, do të mundësojnë lëvizje specifike optimale. Fatkeqësisht, në praktikë, përgatitja

fizike shpesh trajtohet ndaras nga përvetësimi i teknikës sportive në sporte. Me këtë, harrohet se kemi të bëjmë me një proces dinamik, në të cilin njëra kushtëzon tjetrën, dhe se vetëm përgatitja fizike e nivelit të lartë mund të siguroj realizim të lartë të teknikës sportive (Hraski et al., 2003).

Kërkesat teknike-taktike në një numër të madh të disiplinave sportive, sikur që është sporti i volejbollit, përfshin shpesh ushtrime me ndryshime në rrafshin frontal dhe sagjital, lloje të ndryshme të kërcimeve (different types of jumps), midis tyre dhe kërcime të veçanta për një degë të caktuar sportit (Nešić, 2008).

Këto aftësi kërkojnë përgatitje adekuate dhe performancë të lartë në raport me përgatitjen fizike sportive teknike, taktike, bazike dhe specifike motorike, duke pasur parasysh se ekziston numri i madh i teknikave të kërcimeve në varësi të specifikave të sportit (Zatsiorsky and Kraemer, 2006).

Përgatitja e mirë kondicionale, tekniko – taktike do të ndikojë në suksesin e realizimit të testeve situacionale – motorike të loja e volejbollit. Për të qenë në gjendje sportisti i këtyre sporteve ti kryej detyrat e caktuara para se gjithash duhet të posedoj nivelin e lartë të aftësive bazike – motorike të cilat fitohen me stërvitje të rregullta të përgatitjes fizike (Verhejn, 1997; Weineck, 2000). Për të arritur rezultate të larta në nivel botrorë lojtari përveq përgatitjes fizike duhet të posedoj edhe aftësi teknike, taktike, intelektuale dhe përgatitje psikologjike.

Ndërlidhja e përbashkët e këtyre komponenteve ka për qëllim përgatitjen e gjithanshme si të lojtares ashtu edhe të ekipit. Përgatitja teknike është bazë fundamentale e procesit stërvitor secilit lojtarë (Bompa 2006). Suksesi në lojën e volejbollit sikurse edhe në lojrat tjera vjenë si rezultat i karakteristikave antropologjike. Loja e volejbollit bashkohor kërkon përgatitje më të lartë fizike në krahasim me vitet e mëhershme ku qëllim parësor ka qenë përgatitja teknike e lojtares.

Përgatitja fizike është qelësi elementar për sukses në lojën e këtyre sporteve (Wang, 1995). Në bazë të analizave të shumta të strukture së lojës së këtyre sporteve mund të konkludojm se pasimi i topit drejt cakut në mënyrë precize paraqet njërin nga faktorët me rëndësi për arritjen e rezultateve të dëshiruara në lojën e vplejbollit (Joksimović, et al., 2003).

Volejboli sipas karakteristikave që posedon i përkasin lëvizjeve polistrukturale komplekse, dhe numërohet në kategorinë e porteve atraktive ekipore. Suksesi në këto sportet varet nga shumë faktorë ndërmjet veti të lidhura siç janë: karakteristikat morfologjike, aftësitë motorike, aftësitë kognitive, veçoritë konative, strukturës motivuese, karakteristikave

fiziologjike-funksionale, dinamika e rrethit mikro social, elementeve tekniko-taktike të lojës, si dhe struktura morfologjike e lojtarit. Të gjitha këto gërshetohen në strukturë të përbashkët përgjegjëse për rezultatin sa më të mirë në lojën volejbollit. Antropologjia është hapësirë shumë dimensionale, interaktive dhe se për këtë arsye përcaktimi i përshkrimit të atyre modeleve teorike të nën hapësirës relevante të cilat kanë ndikim të rëndësishëm në arritjen e sukseseve në lojën e volejbollit ka rëndësi të madhe.

Sportet ekipore kulmore pjesë në grupin e sporteve anaerobe dhe aerobe me kërkesa të mëdha fizike të këtyre kapaciteteve. Loja e volejbollistëve bazohet në karakteristikat morfologjike dhe aftësitë e përgjithshme motorike, të cilat i mundësojnë arritjen e njohurive në elementet specifike, situaciono tekniko-taktike, relevante për arritjen e suksesit në lojën e volejbollit (Bojic me bashk., 2007).

Orientimi dhe përcaktimi i rinisë për sportin e volejbollit, është i kushtëzuar me dëshirën e vet të riut për këto sporte ekipore ose me anë të selekcionimit nga ana e ekspertëve të këtyre sporteve duke i marr parasysh karakteristikat morfologjike, aftësitë psikomotorike dhe shpejtësinë e të mësuarit si dhe përsosjes së elementeve tekniko-taktike, (Fulgozi, 1994). Seleksionimi, përpos zgjedhjes që duhet bërë, nënkupton edhe orientimin dhe përsosjen e lojtarëve talent dhe potencial kulmor (Paranosic dhe Savic, 1977). Ky është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar i cili kërkon punë ekipore dhe qëndrim multidisiplinar.

Zgjedhja dhe identifikimi i talenteve në lojën e volejbollit dhe zhvillimi i tyre është një ndër komponentet e rëndësishme të programeve sportive esenciale në shumë shtete të zhvilluara. Në përcaktimin dhe formimin e tipareve antropologjike të një popullate të ndonjë shteti ndikim parësor kanë faktorët gjenetik, por nuk duhet lënë anash ndikimin e faktorëve të jashtëm, pra faktorët ekologjik ose të mjedisit të jashtëm. Vendet e zhvilluara fillojnë shumë herët me seleksionimin dhe përzgjedhjen e një kombëtareje, duke zbatuar planprograme të hartuara nëpërmjet Institutit shtetëror apo në kuadër të Fakultetit të Kulturës Fizike, për zhvillimin e sportit (gjë e cila tek ne mungon, për momentin nuk aplikohet). Zhvillimi psikomotorik së bashku me aftësitë tjera antropologjike sidomos morfologjike kanë rol të rëndësishëm në përzgjedhjen e të rinjve, ku është i njohur fakti, se rezultate më të larta arrijnë ata sportistë me karakteristika të vaçanta dhe më të mira nga këto dy lëmi të lartë përmendura. Sipas shumë autorëve dhe nga literatura e shqyrtuar gjerë më tani, hasim se te ata persona që kanë predispozita specifike morfologjike dhe aftësi motorike më të mira, kanë një shkallë më të lartë

të suksesit në sportin e volejbollit, andaj duhet bërë zgjedhja e dimensioneve të nevojshme morfologjike dhe motorike, si dhe duhet bërë zgjedhja e operatorëve adekuat më qëllim të transformimit - orientimit drejt realizimit të rezultateve cilësore në lojën volejbollit.

1.2 HULUMTIMET E DERITANISHME

Shqyrtimi i hulumtimeve të gjertanishme është ndarë në dy pjesë. Pjesa e parë përfshin hulumtimet e gjertanishme në botë dhe një pjesë tjetër përfshin hulumtimet e gjertanishme në Kosovë.

Nesic (2006) ka hulumtuar strukturën e aktiviteteve garuese të shumë reprezentacioneve të suksesshme apo më pak të suksesshme Europiane të Volejbollit në kampionatet evropiane për femra (2001, 2003 dhe 2005). Qëllimi kryesor i hulumtimit ishte për të përcaktuar dallimin në mes strukturës së aktiviteteve garues të ekipeve të suksesshme (të rangut nga e para në vendin e katërt) dhe strukturën e aktiviteteve garuese ekipet më të suksesshme (nga vendi i 5 deri në vendin e 8-të) dhe është përdorur softwari "Data Volley për të mbledhur të dhëna. Rezultatet dhe diskutimi kanë vënë në dukje se këto dy grupe ndryshojnë në: koeficientin e efikasitetit të shërbimit, koeficientin e efikasitetit të bllokut dhe koeficientin e efikasitetit të sulmit. Në hapësirën latente të aktiviteteve garuese janë izoluar dhe interpretuar tre faktorë: faktorit hapësirë-kohë, faktor i precizitetit situacional dhe faktor efikasiteti tekniko-taktik. Në grupin eksperimental janë përdorur ushtrime bench press dhe French-curl, në një periudhë gjashtë javore ku në tre javët e para janë aplikuar ushtrime me ritmin e ngadaltë, dhe në tri javët e fundit mënyra e ushtrimeve eksplozive. Me stërvitje te grupi eksperimental janë rritur rezultatet në bench press (49 + 25.26%, dhe në të njëjtën kohë është rritur efikasiteti në gjuajtje ($p < 0.028$). Në grupin kontrollues nuk është vertetuar marrëdhënie e tillë në mes të forcës dhe precizitetit. Në grupin eksperimental tjetër është testuar hipoteza mbi rolin e forcës të quadricepsit dhe shejtësisë sprinterike. Në të dy grupet eksperimentale (nëntë subjekte kanë ushtruar quadriceps dhe 10 hamstrings ose ushtrime për muskujt e pasëm të këmbëve) ka pasur një rritje në forcën e muskujve të grupeve të muskujve të ushtruar, por vetëm në grupin i cili ka trajnuar muskujt e pasëm të kofshës ka ardh deri te rritja e shpejtësisë sprinterike. Autori këtu e shpjegon se përmirësimi i forcës së muskujve të pasme të kofshës ka ndikuar në efikasitetin e vrapimit, sepse në zinxhirin kinetik të muskujve që janë të angazhuar në vrapimin sprinterik vendoset një balanc me muskulin natyreshëm më të fort dhe shpesh me quadricepsin e angazhuar. Bazuar në rezultatet e dy eksperimenteve, autori arrin në përfundimin se kondicionimi duhet të konsiderohet si një pjesë integrale e teknikave të trajnimit. Për integrimin e saj të suksesshëm

është e nevojshme të kupthet roli e sistemit neuromuskular në karakteristikat e lëvizjes dhe metodë për arritjen e adaptimit special. Këtë njohuri duhet përfshirë në mësuarjen e rradhijes së planifikimit të proceseve të zhvillimit të aftësive.

Karalić me bp. (2012) për lëmi të hulumtimit kanë pasur precizitetin si faktor të suksesit të volejbollistët dhe volejbollistët. Qëllimi i hulumtimit ka qenë të përcaktohet struktura e aftësisë antropomotorike të precizitetit për volejbolliste dhe volejbollistët. Mostra e të anketuarve është përbër nga gjithsej 80 lojtarë dhe lojtare të volejbollit, anëtarë të klubeve të volejbollit të moshës 14-16 vjeç. Janë shfrytëzuar gjashtë teste motorike për të vlerësuar aftësitë e mëposhtme: saktësinë e goditjes së caktit në rrafshin horizontal, saktësinë e goditjes së caktit në rrafshin vërtikal. Është përcaktuar se ekzistojnë disa dimensione brenda hapësirës së vëzhguar të përcaktuar si hapësira e precizitetit. Pastaj, në strukturën e kësaj hapësire tek lojtarët dhe lojtaret e volejbollit, ekzistojnë preciziteti i gjuajtjes së caktit me gishtrinjë dhe "çekiçit" në nivelin horizontal dhe vërtikal. Në përgjithësi arrihet në përfundimin se në strukturën e elementeve teknike-taktike ekzistojnë lloje të veçanta saktësie në volejboll, të cilat mund të definohen si saktësia në teknikën e pasimit të topit me gishtrinjë, teknika e pasimit të topit me "çekiç" dhe teknika e gjuajtjes mbi rrjetë.

Milić, Nešić, Trajković dhe Radenković (2012) si qëllim të hulumtimit kanë pasur të përcaktin dallimet në aftësitë e situacionale motorike (precizitet) dhe efikasitetin në lojën e volejbollit të rangut të parë dhe të dytë të Serbisë. Hulumtimi ka përfshirë 100 të testuar - lojtarë të volejbollit, garues aktivë, të ndarë në dy nën-nëngrupe. Nëngrupin e parë e ka përbër gjysma e mostrës që përfshihen në tri klubet e Ligës së Parë. Nëngrupi i dytë përbëhet nga garuesit nga tre klubet e Ligës së dytë të Serbisë. Analiza e efikasitetit të lojtarëve dhe ekipit bazohet në vlerësimin e efikasitetit të katër variablave teknik-taktikë: shërbimi, ngritja, pranimiti i shërbimeve dhe gjuajtja mbi rrjetë. Një ndryshim statistikor i rëndësishëm u gjet në pothuajse të gjitha variablat e situacioni-motorike të precizitetit. Rëndësia e teknikave elementare në nivele të ndryshme të garave mund të konfirmohet në punime të tilla. Autorët pohojnë se hulumtimi i ardhshëm duhet të merren me testet e saktësisë së volejbollit, por edhe në kushtet e lodhjes fizike, sepse performanca e elementeve teknike në kushte të tilla është ajo që pritet gjatë ndeshjes.

Nesic, Ilic, Majstorovic, Grbic dhe Osmankač (2013) në një mostër prej 40 femrave, të moshës 13 dhe 14 vjet, vajzat e shkollës volejbollit "Dif" nga Beogradi, kanë tentuar të paraqesin

ndikimin e trajnimint në volejball në ndryshimet bazike dhe aftësitë specifike motorike. Variablat aplikuar janë ndarë në dy nëngrupe, variablat për vlerësimin aftësive bazike motorike dhe variablat për vlerësimin e aftësive specifike motorike. Në ditën e parë u bënë matjet e peshës trupore dhe lartësia, dhe pastaj, testet: kërcim së gjati (SUD), kapje në bllok (DUB), vrapim 20 m (TRC), dhe ditën tjetër më teste të tjera: Russell Lang-së testi me gishtrinjin (RLTP), Russel Lang testi „çekiç“ (RLTC) dhe të shërbimi (RLTS). Ri-testimi u krye pas tre muajve të procesit të trajnimit. Procesi eksperimentale është bërë gjatë tre muajve dhe autorët theksojnë se njësitë e trajnimit janë bërë 4 herë në javë. Rezultatet tregojnë se ka një ndryshim pozitiv në të gjithë variablat pas tre muajve të trajnimit.

Bojanic, Petkovic, Gardašević, Muratovic dhe Vasiljevic (2015) theksojnë se objektivi kryesor i studimit ishte të përcaktojnë ndikimin e potencialeve bazike motorike (sistem i pavarur prediktor i variablave), në aftësitë situacionale-motorike te lojtarët e volejbollit (variablat kriterike të varura). Testimi u krye në një mostër prej 75 të testuarve, të cilët garojnë në Ligën e Parë Malazeze. Janë zgjedhur 5 ekipet e para të ranguar, dhe për vlerësimin e aftësive bazike motorike është përzgjedhur subhopsira e cila është konsideruar si kryesor në zbatimin e strukturave komplekse lëvizore të cilat janë të mjaftueshme në lojën volejball. Këto aftësi janë paraqitur me anë të testeve të cilat përcaktojnë: koordinimin, shpejtësin, forcën shpërthyes, forcën repitative dhe fleksibiliteti me një total prej 15 variablave. Motorika situacionale është vlerësuar me 5 faktorë hipotetike: saktësi të dëbimit dhe pasimit të top me gishta, preciziteti i dëbimit dhe pasimit të topit me parallëra, preciziteti i shërbimit, , preciziteti i gjuajtjes mbi rrjetë, dhe forca e dëbimit dhe goditjes së topit, dhe kjo hapësirë është e përfaqësuar me 11 variablave. Rezultatet e fituara tregojnë me anë të testimit (bazuar në analizën e regresionit) se ekziston një ndikim i rëndësishëm statistikor të potencialit bazike motorike në aftësitë situacionale motorike te lojtarët e volejbollit.

Asllani (2014) në punimin e saj për qëllimi i kishte të përcaktohet raporti dhe ndikimi i forcës eksplozive dhe fleksibilitetit në realizimin e detyrave të precizitetit situacional në volejbollit. Specifikat e sporteve në rrjetë janë se në lojën e volejbollit lojtari apo ekipi realizon pikë duke goditur topin në hapësirën e fushës me forcë dhe precizitet të mjaftueshëm, në mënyrë që kundërshtari nuk është në gjendje të kthejë topin para se të bie një herë në fushë. Janë parashtruar tri hipoteza alternative të cilat janë realizuar në tërësi. Mostra ka përfshirë 110

student. Studentët janë testuar në sallën pranë Fakultetit të Shkencave Sportive në Prishtinë. Për realizimin e këtij punimi janë aplikuar gjashtë ndryshore të forcës eksplozive, katër ndryshore motorike të fleksibilitetit dhe gjashtë ndryshore situacionale motorike të precizitetit. Për përpunimin e rezultateve dhe vërtetuar ndikimin e ndryshoreve predikatore të forcës eksplozive dhe të fleksibilitetit në ato kriterike ndryshore motorike situacionale të precizitetit është aplikuar analiza regresive. Me anë të analizës regresive tek studentët është vërtetuar vlera e lidhmënisë ndërmjet grupit të variablave të pavarura prediktore (aftësive motorikë të forcës eksplozive dhe fleksibilitetit dhe variables të varur kriterike (ndryshoreve motorike të precizitetit situacional). Rezultatet e fituara tregojnë se nga ndryshoret të forcës eksplozive dhe fleksibilitetit, si ndryshore prediktore, kanë ndikim në manifestimin e precizitetit situacional vetëm në dy nga gjashtë ndryshoret kriterik edhe ato: Pasimi i topit me gishtërinjë në cak (MSDGCA) dhe Pasimi i topit me “çekan” në cak (MSDCCA)

Istogu (1915) në punimin e tij si qëllim kishte vërtetimin e dallimeve në disa aftësi motorike të forcës eksplozive, forcës statike, fleksibilitetit dhe ndryshoreve të precizitetit situacional te volejbollistet para dhe pas përgatitjes kondicionalë dhe teknike në fazën përgatitore. Mostra ka përfshirë 20 volejbolliste nga KV “Skenderaj”. Volejbollistet janë testuar në sallën e qyteti të Skenderajt ku zhvillohen garat e volejbollit duke i plotësuar të gjitha kushtet për matje. Matjet janë ekzekutuar në orët e pasdites gjatë vitit kalendarik Shkurt – matjet e para, prill 2014 matjet finale. Ndryshoret të cilat janë aplikuar në këtë hulumtim janë ndryshore të natyrës motorike. Janë aplikuar 6 ndryshore të forcës eksplozive, 4 ndryshore të fleksibilitetit, 6 ndryshore të forcës statike dhe 4 ndryshore motorike situacionale të precizitetit. Dallimet e fituara te volejbollistet në ndryshoret motorike tregojnë se gjatë fazës përgatitore nuk iu është kushtuar aq sa duhet ushtrimeve të fleksibilitetit dhe të forcës statike çka tregojnë rezultatet e fituara pas përpunimit statistikor me anë të **t-testit** për ndryshore të varura.

2. QËLLIMI DHE DETYRAT

Specifikat e sporteve në rrjetë janë se në lojën e volejbollit lojtaret apo ekipi realizon pikë duke goditur topin në hapësirën e fushës me forcë dhe precizitet të mjaftueshëm, në mënyrë që kundërshtari nuk është në gjendje të kthejë topin para se të bie një herë në fushë.

Për të arritur këtë lojtarja duhet të ketë ato aftësi motorike në volejboll që janë përgjigjëse për suksesin e saj. Prandaj edhe nga kjo kërkesë në aspektin antropologjik lind edhe qëllimi i këtij punimi e që është vërtetimi i ndikimit të forcës eksplozive dhe forcës statike në realizimin e detyrave motorike specifike në volejbollit

Detyrat – Për realizimin e qëllimit të parashtruar, janë parashtruar këto detyra të hulumtimit:

- Të përcaktohet niveli i zhvillimit motorik i forcës eksplozive, forcës statike dhe precizitetit situacional,
- Të përcaktohet niveli i ndërlidhjeve brenda grupit sipas instrumenteve matëse.
- Të përcaktohet niveli i ndikimit të forcës eksplozive dhe forcës statike në realizimin e detyrave të precizitetit situacional në volejbool.

3. HIPOTEZAT THEMELORE

Në harmoni me qëllimin dhe metodat për përpunimin e rezultateve do të parashtrihen këto hipoteza:

H1- Distribucioni i fituar i ndryshoreve të forcës eksplozive, forcës statike dhe motorike specifike nuk do të kenë asimetri të theksuar

H2 – Korelacionet ndërmjet ndryshoreve të forcës eksplozive, forcës statike dhe motorike specifike do të jenë më të larta se zero.

H3 – Rezultatet e ndryshoreve të forcës eksplozive dhe forcës statike, si ndryshore prediktore, do të kenë ndikim në manifestimin e precizitetit situacional.

4. MOSTRA E ENTITETIT / TË TESTUARËVE/

Popullata nga e cila do të merret mostra e të testuarëve është definuar si popullatë studentëve të vitit të parë që i kanë mësuar elementet teknike nga lënda e volejboollit të aplikuar në këtë punim. Mostra ka përfshirë 30 volejbolliste nga mosha 18-28 vjeçare të KV „Skenderaj“ nga Skenderaji. Volejbollistet janë testuar në sallën e qyteti të Skenderajit. Matjet janë ekzekutuar në orët e pasdites gjatë vitit kalendarik mars të vitit 2019.

4.1. MOSTRA E NDYSHOREVE

4.2.1 Ndryshoret prediktore të forcës eksplozive

Për vlerësimin e aftësive motorike të forcës eksplozive janë përfshirë këto variabla:

1. **MKGJVE**.....Kërcim së gjati nga vendi
2. **MKLAVE**..... Kërcim së larti nga vendi
3. **MKMKED**..... Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë
4. **MKMKEM**.....Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë.
5. **MHTMSH**.....Hudhja e topit medicinal shtrir.
6. **MHTMGU**..... Hudhja e topit medicinal në nivel të gjoksit ulur.

4.2.2 Ndryshoret e forcës statike

Për identifikimin e aftësive motorike të forcës statike janë aplikuar këto ndryshore:

- MMSGJP**.....Forca statike gjysmë pompë
- MMSVAR**Qëndrim në varje në hekur me bërryla të thyer 90^0
- MMSQKM**Qëndrimi i këmbëve të shtrira mbi top
- MMSQTB**Qëndrimi i trupit të shtrirë barkas
- MMSGJU**.....Qëndrimi gjysmë ulur
- MMSGJN**Qëndrimi gjysmë ulur me një këmbë

4.2.3 Ndryshoret motorike specifike

Për identifikimin e aftësive motorike specifike të precizitetit në lojën e volejbollit janë aplikuar këto ndryshore:

1. Preciziteti në cakun vertikal me gishtrinj (MPCVG)
2. Preciziteti në cakun vertikal me parallëra (“çekiç”) (MPCVÇ)
3. Preciziteti i shërbimit -Tennis shërbimi (MSHTE)
4. Dëbimi i topit me gishtrinj (MSDTG)
5. Dëbimi i topit me parallëra (“çekiç”) (MSDTÇ)

4.3. PËRSHKRIMI I INSTRUMENTEVE MATËSE

4.3.1. Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike të forcës eksplozive

1. Kërcim së gjati nga vendi – MKGJVE

Instrumentet: Dysheku i gjimnastikës dhe metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për kërcim.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron i kthyer me fytyrë kah drejtimi i kërcimit në pozitë drejtpëndrimi me këmbë të thyera në gjunjë që mundëson kërcim më të suksesshëm.

Realizimi i detyrës: E testuara kërcen tri herë, duke përsëritur kërcimet njërin pas tjetrit. Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: Matet gjatësia e kërcimit prej vijës shtytëse e deri te gjurmët e shputave (pjesa fundore). Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu epen gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.



2. Kërcim së larti nga vendi – MKLAVE.

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjërësi të legenit.

Realizimi i detyrës: E testuara e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalishtë, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë , i testuari kërcen vertikalishtë në lartësi (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarve udhëzimet iu epen gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.



3. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë - MKLKED

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi. **Përshkrimi i detyrës:**

Pozita fillestare: E testuara vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit.

Realizimi i detyrës: E testuara e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë, e testuara kërcen vertikalisht në lartësi me këmbën e djathtë (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave udhëzimet iu janë dhënë gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.



4. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë - MKLKEM

Instrumentet: Metri metalik i vendosur në dy anët e murit për kërcim. Lartësia në mur është shënuar me cm deri mbi 3 m. lartësi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara vendoset brinjazi pranë murit, shputat janë të vendosura në gjerësi të legenit.

Realizimi i detyrës: E testuara e ngrit dorën e cila është afër murit dhe me pëllëmbë të shtrirë maksimalisht, kurse testuesi regjistron lartësinë e prekjes së parë, a testuara kërcen vertikalisht në lartësi me këmbën e majtë (tre tentime). lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Rezultati shënohet me saktësi prej 1 cm.

Vlerësimi: lexohet rezultati më i mirë prej prekjes së parë deri në kërcimin maksimal, lexohet diferenca në cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave udhëzimet iu janë dhënë gjatë demonstrimit të detyrës, se si duhet të kryhet detyra. E testuara bënë disa tentime provuese.



5. Hedhja e topit medicinal nga pozita e shtrirë - MHTMSH

Instrumentet: topi medicinal i peshës 3 kg, metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për hedhjen e topit medicinal

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron në pozitë të shtrirë, fytyrë nga lartë, me këmbë të zgjeruara në nivel të kërdhokullave dhe mban topin me dy duar të shtrira lartë mbi kokë.

Realizimi i detyrës: E testuara nga pozita e të shtrirë me fytyrë nga drejtimi i shtytjes hedhë topin medicinal sa ma larg që është e mundur. Detyra përsëritet dy herë. I testuari qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e hedhjes.

Vlerësimi: Shënohet rezultati i hedhjes e shënuar me centimetra. Pika zero është në fillim të hedhjes, saktësia e matjes 0,5 cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. U tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.



6. Huhja e topit medicinal në nivel të gjoksit ulur- MHTMGU

Instrumentet: topi medicinal i peshës 3 kg, metri metalik i vendosur në dy anët e vendit për hedhjen e topit medicinal

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron në pozitë të drejtqëndrimit, fytyrë nga drejtimi i shtytjes së topit medicinal, me këmbë të zgjeruara në nivel të kërdhokullave dhe mban topin me dy duar në nivel të gjoksit.

Realizimi i detyrës: E testuara nga pozita e drejtqëndrimit me fytyrë nga drejtimi i shtytjes hedhë topin medicinal sa ma larg që është e mundur. Detyra përsëritet dy herë. I testuari qëndron në pozitën e fundit që leximi të jetë sa më i saktë dhe të shikohet rregullsia e hedhjes.

Vlerësimi: Shënohet rezultati i hedhjes e shënuar me centimetra. Pika zero është në fillim të hedhjes, saktësia e matjes 0,5 cm.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës. U tregohet për pozitat e rregullta dhe ato të parregullta.



4.3.2. Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike të forcës statike

1. Forca statike gjysmë pompë – MFSGJP

Instrumentet domosdoshme: detyra ekzekutohet në sipërfaqe të rrafshët dhe pa rekuizita.

Përshkrimi i detyrës:


Pozita fillestare: E testuara merr pozitën për ekzekutimin e përkuljes në duar. Bërrylat janë të larguar në distancë të caktuar. Llërat janë të vendosura ashtu që gjenden në nivel të kraharorit. Krahët janë të vendosur ashtu që gjenden në vazhdim të nivelit të kraharorit. Trupi me këmbë të shtrira dhe të bashkuara mbështeten në gishttrinjtë e këmbëve.

Realizimi i detyrës: E testuara lëshohet deri në pozitën kur llërat gjenden në pozitë paralele me sipërfaqen e mbështetjes. E testuara mundohet që të qëndroj në këtë pozitë sa ma gjatë.

Kryerja e detyrës: Detyra ndërpritet kur e testuara lëshon pozitën e paraparë.

Vlerësimi i detyrës: Rezultati matet me të dhjetat e sekondës nga momenti kur i testuari merr pozitën e caktuar e deri te lëshimi i pozitës së caktuar.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.



2. Qëndrim në varje në hekur me bërryla të thyer 90°-MFSVAR

Instrumentet domosdoshme: Hekuri gjimnastikor.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara hipur në karrigë merr pozitën për ekzekutimin e qëndrimit me duar të thyera në varje në hekur me nënkapje. Krahët janë të vendosur ashtu që gjenden në vazhdim të nivelit të kraharorit.

Realizimi i detyrës: E testuara lëshohet ngritët në duar në pozitën kur llërat dhe parallërat gjenden në pozitë 90°. E testuara mundohet që të qëndroj në këtë pozitë sa ma gjatë.

Kryerja e detyrës: Detyra ndërpritet kur e testuara lëshon pozitën e paraparë.

Vlerësimi i detyrës: Rezultati matet me të dhjetat e sekondës nga momenti kur i testuari merr pozitën e caktuar e deri te lëshimi i pozitës së caktuar.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.



3. Qëndrimi i këmbëve të shtrira mbi top - MFSQKM

Instrumentet domosdoshme: Topi medicinal, kronometri

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuari ulet në dysheme dhe me duar të vendosura prapa fikson pjesën e trupit gjatë ekzekutimit të detyrës. Topi medicinal është i vendosur nën shputat e këmbëve të shtrira.

Realizimi i detyrës: E testuara këmbët e shtrira dhe të bashkuara i vendos mbi topin medicinal dhe i ngrit në lartësi prej 10 cm mbi top.

Kryerja e detyrës: Detyra ndërpritet kur i testuari lëshon pozitën e paraparë.

Vlerësimi i detyrës: Rezultati matet me të dhjetat e sekondës prej momentit kur e testuara merr pozitën e caktuar e deri te lëshimi i kësaj pozite.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.



4. MFSQTT – Qëndrimi i trupit të shtrirë me fytyrë nga poshtë

Instrumentet domosdoshme: Ulësja suedeze, dysheku gjimnastikor dhe shkopi.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara e shtrirë me fytyrë nga poshtë në ulësen suedeze e cila është e mbuluar me dyshekë, fikson këmbët e shtrira në shpatullore në nivel të dyshekut. Ulësja suedeze është e vendosur paralel me shpatulloren.

Realizimi i detyrës: E testuara lëshohet deri në pozitën horizontale barkas, me mbështetje deri te kërdhokullat, dhe në atë pozitë tenton që të qëndroj sa më gjatë.

Kryerja e ekzekutimit: Detyra ndërpritet, atëherë kur i testuari lëshon pozitën horizontale.

Vlerësimi i detyrës: Rezultati metët me të dhjetat e sekondës prej momentit kur i testuari lëshohet në pozitë horizontale e deri te lëshimi i kësaj pozite.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.



5. Qëndrimi gjysmë ulur - MFSGJU

Instrumentet domosdoshme: Testi ekzekutohet në sipërfaqe të rrafshët.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: E testuara qëndron në drejtqëndrim këmbët e hapura në nivel të kërdhokullave.

Realizimi i detyrës: E testuara lëshon peshën e trupit në pozitën gjysmë ulur ashtu që këndi në mes kofshës dhe kërcirit të jetë 90 shkallë.

Kryerja e detyrës: Detyra ndërpritet atëherë kur e testuara lëshon pozitën e paraparë.

Vlerësimi i detyrës: Rezultati matët me të dhjetat e sekondës prej momentit kur i testuari merr pozitën e caktuar e deri te lëshimi i pozitës së paraparë.

Udhëzime të testuarit: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.



6. MFSGJU1 – Qëndrimi gjysmë ulur me një këmbë

Instrumentet domosdoshme: Testi ekzekutohet në sipërfaqe të rrafshët.

Përshkrimi i detyrës:

Pozita fillestare: Qëndrimi këmbë hapur.

Realizimi i detyrës: E testuara lëshon peshën e trupit në këmbën e majtë ashtu që në këmbën e majtë pozita e kofshës dhe e nëngjurit të jetë 90 shkallë. Këmba tjetër është e shtrirë në të djathtë.

Kryerja e detyrës: Detyra ndërpritet atëherë kur i testuari lëshon pozitën e parapa.

Vlerësimi i detyrës: Rezultati matët me të dhjetat e sekondës prej momentit kur i testuari merr pozitën e caktuar e deri te lëshimi i pozitës së paraparë.

Udhëzime të testuari: Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës



4.3.3 Përshkrimi i instrumenteve matëse motorike specifike të precizitetit

1. Preciziteti në cakun vertikal me gishtrinj (MPCVG)

Instrumentet: Topi i volejbollit, katrori 35x35 në lartësi 243 cm, distanca 1 m

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari qëndron në drejtqëndrim para vijës së ekzekutimit në largësi 1 m.

- **Realizimi i detyrës:** I testuari fillon pasimin me ngritjen e topit mbi kokë dhe fillon pasimin e topit në cakun ose **katrorin 35x35 në lartësi 243 cm pa ndërprer.**

- **Vlerësimi:** Testi përsëritet dy herë. I testuari tenton sa ma teper të pasoj topa në **katrorin 35x35 në lartësi 243 cm** . Numërimi ndërpritet në rastin kur i testuari nuk e qëllon pasimin në katrorin e vendosur në mur ose kur i bënë 60 pasime pa ndërprer..

- **Udhëzime të testuarit:** Të testuarit iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.



2. Preciziteti në cakun vertikal me parallëra (“çekiç”) (MPCVÇ)

Instrumentet: Topi i volejbollit, katrori 3 metra i lartë dhe i gjerë 1 metër (3x1 m), distanca 2.5 m.

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** E testuari qëndron në drejtëqëndrim para vijës së ekzekutimit në largësi prej 2.5 m.

- **Realizimi i detyrës:** E testuari fillon pasimin me ngritjen e topit mbi kokë dhe fillon pasimin e topit me “çekan” në cakun ose **katrorin 3x1 m në largësi prej 2.5 m pa ndërprer.**

- **Vlerësimi:** Testi përsëritet dy herë. E testuara tenton sa ma teper të pasoj topa në **katrorin 3x1**. Numërimi ndërpritet në rastin kur i testuari nuk e qëllon pasimin në katrorin e vendosur në mur ose kur i bënë 60 pasime pa ndërprer.

- **Udhëzime të testuarit:** Të testuarave iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.



3. Preciziteti i shërbimit -Tenis shërbimi (MSHTE)

Instrumentet: Topi i volejbollit, njëra pjesë e fushës së volejbollit e ndarë në 6 katror 3x4.5 metra (6,2,4,3,1,5).

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari qëndron në drejtëqëndrim para vijës së ekzekutimit të shërbimeve.

- **Realizimi i detyrës:** I testuari fillon shërbimet shkollore me ngritjen e topit mbi kokë. Gjuan gjithsej 6 shërbime. Me dy pikë vlerësohet gjuajtja në fushën e caktuar, me një pikë vija e fushës së kufizuar dhe me 0 pikë dështimi i caktuar.

- **Vlerësimi:** I testuari tenton sa më saktë të qëllojë fushat e caktuara nga shërbimi.

- **Udhëzime të testuarit:** Të testuarit iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës.



4. Dëbimi i topit me gishtrinj (MSDTG)

Instrumentet: Topi i volejbollit, katrori 2x2 m në dysheme.,

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari qëndron në drejtëqëndrim brenda vijës së ekzekutimit ose brenda katrorit 2x2 m në dysheme i përgatitur për përsëritjen e pasimeve të topit me gishtrinjë në lartësi 1 m mbi kokë.

- **Realizimi i detyrës:** I testuari fillon pasimin me ngritjen e topit mbi kokë dhe fillon pasimin e topit mbi kokë me gishtrinjë brenda katrorit 2x2 m. pa ndërpreje. Nëse del nga katrori ndërpritet numërimi.

- **Vlerësimi:** I testuari tenton sa ma teper të pasoj topa me gishtrinjë mbi kokë pa ndërprerë deri sa të del nga katrori ose i bënë 60 opasime pandërprerë.

- **Udhëzime të testuarit:** Të testuarit iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës



5. Dëbimi i topit me me parallëra (“çekiç”) (MSDTÇ)

Instrumentet: Topi i volejbollit, katrori 2x2 m në dysheme.,

- **Përshkrimi i detyrës:**

- **Pozita fillestare:** I testuari qëndron në drejtëqëndrim brenda vijës së ekzekutimit ose brenda katrorit 2x2 m në dysheme i përgatitur për përsëritjen e pasimeve të topit me “çekan” në lartësi 1 m mbi kokë.

- **Realizimi i detyrës:** I testuari fillon pasimin me ngritjen e topit mbi kokë dhe fillon pasimin e topit mbi kokë me “çekan” brenda katrorit 2x2 m. pa ndërpreje. Nëse del nga katrori ndërpritet numërimi.

- **Vlerësimi:** I testuari tenton sa ma teper të pasoj topa me “çekan” mbi kokë pa ndërprerë deri sa të del nga katrori ose i bënë 60 opasime pandërprerë.

- **Udhëzime të testuarit:** Të testuarit iu jepen udhëzime gjatë demonstrimit të detyrës



4.4. METODAT PËR PËRPUNIMIN E REZULTATEVE

Në bazë të qëllimit dhe hipotezave të parashtruara, janë aplikuar metodat e përpunimit të rezultateve të cilat mundësojnë sigurimin e informatave të mjaftueshme për realizimin e qëllimit. Për sistemin e variablove variablove të forcës eksplozive, fleksibilitetit dhe variablove të precizitetit situacional do të llogariten parametrat themelorë statistikorë dhe të shpërndarjes për secilën variabël, si dhe masat e asimetrisë dhe të shpërndarjes normale.

- Vlerat minimale dhe maksimale (**R.min-R.maks**),
- Mesatarja aritmetikore (**Ma**),
- Devijimi standard (**Ds**) dhe
- Parametrat e asimetrisë (**SKEW dhe KURT**).

Raportet e ndërlidhjeve ndërmjet variablove të forcës eksplozive, forcës eksplosive dhe variablove të precizitetit situacional në hapësirën manifeste, si dhe korrelacionet ndërmjet sistemit të variablove.

Për përcaktimin e ndikimit të variablove të forcës eksplozive dhe forcës statike, në ndryshoret specifike precizitetit është aplikuar **analiza regresive**.

5. INTERPRETIMI I REZULTATTEVE DHE DISKUSUTIMI

5.1. INTERPRETIMI I REZULTATTEVE TE VOLEJBOLLISTET

5.1.1 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS EKSPLOZIVE TE VOLEJBOLLISTET


Në tabelën 1 dhe histogramin 1-6 është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve motorike të forcës eksplozive, të volejbollistëve të KV „Skenderaj“ nga Skenderaji. Mostra ka përfshirë 30 volejbolliste nga mosha 18-28 vjeçare seniorë, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetike, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – asim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Tabela 1. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve motorike të forcës eksplozive të volejbollistëve

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
MKGJVE	30	175.00	245.00	201.7667	18.08730	.389	-.729
MKLAVE	30	35.00	60.00	45.6333	6.76443	.377	-.751
MCLKED	30	23.00	40.00	30.7000	3.66860	.144	.843
MCLKEM	30	20.00	36.00	28.1667	3.64912	-.052	.029
MHTMSH	30	460.00	680.00	568.6667	50.49639	-.219	.187
MHTMGU	30	410.00	620.00	486.3667	64.05143	.615	-1.019


Mesatarja aritmetikore e ndryshores kërcim së gjati nga vendi (**MKGJVE**) është 201.76 cm. Rezultati minimal (175.00 cm) dhe ai maksimal (245.00 cm) i ndryshores kërcim së gjati nga vendi tregon se ekziston një dallim të theksuar në mes volejbollisteve në këtë ndryshore motorike të forcës eksplozive, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultati më i ulët , sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Volejbollistet në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore motorike paraqiten si grup homogjen me një numër më të madhe të vlerave kah ato më të ulëta. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Histogrami 1. Kërcim së gjati nga vendi




Mesatarja aritmetikore e ndryshores kërcim së larti nga vendi (MKLAVE) është 45.63 cm. Rezultati minimal (35.00 cm) dhe ai maksimal (60.00 cm) i ndryshores kërcim së larti nga vendi tregon se ekziston një dallim të theksuar në mes volejbollistëve në këtë ndryshore motorike të forcës eksplozive, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultati më i ulët , sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Volejbollistet në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore motorike paraqiten si grup mesatarisht homogjen me një numër më të madhe të vlerave kah ato më të ulëta. Edhe pse ekziston dallim i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Histogrami 2. Kërcim së larti nga vendi




Mesatarja aritmetikore e ndryshores Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë (MKLKED) është 30.70 cm. Rezultati minimal (23.00 cm) dhe ai maksimal (40.00 cm) i ndryshores kërcim së gjati nga vendi tregon se ekziston një dallim të theksuar në mes volejbollisteve në këtë ndryshore motorike të forcës eksplozive, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultati më i ulët, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Volejbollistet në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore motorike paraqiten si grup mesatarisht heterogjen me një numër më të madhë të vlerave kah ato më të ulëta (në të majtë). Edhe pse ekziston dallimi i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Histogrami 3. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e djathtë




Mesatarja aritmetikore e ndryshores Mesatarja aritmetikore e ndryshores Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë. (MKLKEM) është 28.16 cm. Rezultati minimal (20.00 cm) dhe ai maksimal (36.00 cm) i ndryshores Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë tregon se ekziston një dallim të theksuar në mes volejbollisteve në këtë ndryshore motorike të forcës eksplozive, si dhe një anim të lehtë të ndryshores ka rezultati më i lartë, sepse testi i asimetrisë është negativ (hipokurtik). Volejbollistet në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore motorike paraqiten si grup heterogjen me një numër më të madhe të vlerave kah ato më të larta (në të majtë). Edhe pse ekziston dallimi i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë për një asimetri të theksuar.

Histogrami 4. Kërcim së larti nga vendi me këmbën e majtë.




Mesatarja aritmetikore e ndryshores Hudhja e topit medicinal shtrir (MHTMSH) është 568.66 cm. Rezultati minimal (460.00 cm) dhe ai maksimal (680.00 cm) i ndryshores Hudhja e topit medicinal shtrir tregon se ekziston një dallim të theksuar në mes volejbollisteve në këtë ndryshore motorike të forcës eksplozive, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshores ka rezultati më i larta, sepse testi i asimetrisë është negativ (hipokurtik). Volejbollistet në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore motorike paraqiten si grup mesatarisht heterogjen me një numër më të madhe të vlerave kah ato më të larta (në të djathtë). Edhe pse ekziston dallimi i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Histogrami 5. Hudhja e topit medicinal shtrir (MHTMSH)



Mesatarja aritmetikore e ndryshores Hudhja e topit medicinal në nivel të gjoksit ulur (MHTMGU) është 486.36 cm. Rezultati minimal (410.00 cm) dhe ai maksimal (620.00 cm) i ndryshores Hudhja e topit medicinal në nivel të gjoksit ulur tregon se ekziston një dallim të theksuar në mes volejbollisteve në këtë ndryshore motorike të forcës eksplozive, si dhe një anim të lehtë të mesatares së ndryshores ka rezultati më i ulët, sepse testi i asimetrisë është pozitiv (epikurtik). Volejbollistet në bazë të rezultateve të arritura në këtë ndryshore motorike paraqiten si grup mesatarisht heterogjen me një numër më të madhë të vlerave kah ato më të ulëta (në të majtë). Nga dallimi i theksuara në mes rezultatit minimal dhe atij maksimal, shihet se lakueshmëria dhe konveksiteti i fituar (Skewness dhe Kurtosis) nuk tregojnë një asimetri të theksuar.

Histogrami 6. Hudhja e topit medicinal në nivel të gjoksit ulur



5.1.2 ANALIZA DESKRIPTIVE E NDREYSHOREVE MOTORIKE TË FORCËS STATIKE TE VOLEJBOLLISTET


Në tabelën 2 dhe histogramin 7-12 është paraqitur analiza deskriptive e ndryshoreve motorike të forcës statike te volejbollistet e KV „Skenderaj“ nga Skenderaji. Mostra ka përfshirë 30 volejbolliste nga mosha 18-28 vjeçare seniore, ku janë të paraqitura vlerat e mesatares aritmetikore, rezultati minimal, rezultati maksimal, devijimi standard, koeficienti i variacionit, parametrat e shpërndarjes ose të asimetrisë (Skewness – anim, asimetri) dhe shkalla e shtrirjes së kulmit të lakores të distribucionit të rezultateve (Kurtosis – konveksitet).

Tabela 2. Parametrat themelor statistikor të ndryshoreve motorike të forcës statike te volejbollistet

	N	Minimum	Maximum	Mean	Std. Deviation	Skewness	Kurtosis
MFSGJP	30	23.10	75.13	47.8423	15.66158	.018	-1.216
MFSVAR	30	10.30	30.70	19.7520	7.46238	-.003	-1.731
MFSQKM	30	22.30	136.90	52.8977	34.98962	1.500	.937
MFSQTB	30	93.13	240.30	170.7717	43.37991	.151	-.951
MFSGJU	30	58.90	228.50	105.0260	43.55368	1.411	1.989
MFSGJN	30	41.57	182.10	76.9860	36.53966	2.100	3.424


